



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 15817/ Prot.

Tiranë, më 12/04/2016

Drejtuar: ZNJ. MILVA EKONOMI
Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Subjekti: Miratimi i tarifave

E nderuar kolege,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj me shkresë nr. 9039/1, datë 9.03.2016 lidhur me miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit ndaj të tretëve, shprehemi dakord me tarifat e propozuara nga ana Juaj.

Me respekt,

DPS	
Nr 45/1	Dos 1
Dt. 18.05.2016	Vt.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

DCL MP
Për udyshje dhe zbatim
18.05.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Nr. 45 Prot.

Tiranë, më, 10 / 02 /2016

Drejtuar: Zotit Frederik SEITI
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Për dijeni: Drejtorisë së Tregut të Brendshëm
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Tiranë

Lënda: Miratimi i tarifave për shërbimet që Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit i ofron të tretëve

I nderuar Zoti SEITI,

Në zbatim të VKM nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe bazuar në shkonjën II) të nenit 14 të Ligjit nr.9870, datë 4.2.2008 “Për Standardizimin”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e tarifave për shërbimet që Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) i ofron të tretëve sipas listës bashkëlidhur të specifikuar si vijon:

- Për të gjitha Standardet Shqiptare (SSH) të publikuara nga DPS, qofshin këto standarde puro Shqiptare apo që adoptojnë ato europiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO e IEC), do të aplikohet çmimi për faqe siç jepet në listën bashkëlidhur;
- Për të gjitha Standardet Shqiptare (SSH) të publikuara nga DPS, qofshin këto standarde puro Shqiptare apo që adoptojnë ato europiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO e IEC), që kërkohen nga studentët çmimi është sa 15% e çmimit për faqe siç jepet në listën bashkëlidhur;
- Përsoneat (fizikë dhe/ose juridikë), që blejnë më shumë se 10 standarde përfitojnë një ulje prej 10% e totalit të vlerës së standardeve të kërkuara;
- Agjentët e shitjes, specifikuar në marrëveshjet e lidhura ndërmjet DPS-së dhe atyre, përfitojnë 30% të totalit të vlerës për të gjitha shitjet e standardeve (SSH) të realizuara prej tyre, ndërsa pjesa tjetër prej 70% i kalon DPS-së;
- Për bashkëpunëtorët* e DPS-së çmimi është sa 50% e çmimit për çdo standard të kërkuar, siç jepet në listën e çmimeve bashkëlidhur.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Sqarojmë se lista me çmimet për çdo standard, sipas numrit të faqeve, siç jepet në listën bashkëlidhur kësaj shkrese, është miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr.76/1 Prot, datë 1.2.2007 "Miratim i tarifave të shitjes së standardeve", kopja bashkëlidhur, mbi bazën e të cilës DPS aplikon tarifat për shitjen e standardeve.

Arsyeja e kërkesës për të miratuar listën e çmimeve për standardet e publikuara nga DPS, të ndara sipas kategorive të blerësve siç jepet edhe më lart, është për shkak të ndryshimeve në bazën ligjore në fushën e standardizimit, përkatësisht shfuqizimi i ligjit 8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin" dhe zëvendësimi i tij me Ligjin 9870, datë 4.2.2008 "Për Standardizimin", i ndryshuar.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,



DREJTORI PËRGJITHSHËM

Riza HASANAJ

**Bashkëpunëtorë janë të gjithë përfaqësuesit e palëve të interesuara, të cilët, bazuar në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr.9870, datë 4.2.2008 "Për Standardizimin", i ndryshuar, kontribuojnë vullnetarisht në procesin e punës për hartimin dhe miratimin e standardeve, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Komitetet Teknike të DPS-së.*

ÇMIMET E SHITJES SË STANDARDEVE SHQIPTARE

Kodi (Grupi)	Numri i faqeve	Çmimi / lekë		Kodi (Grupi)	Numri i faqeve	Çmimi / lekë	
		Bashkëpunëtorë	Jobashkëpunëtorë			Bashkëpunëtorë	Jobashkëpunëtorë
A.	1 - 2	595	1190	XA.	101 - 120	3510	7021
B.	3 - 4	684	1368	XB.	121 - 150	3748	7497
C.	5 - 6	803	1606	XC.	151 - 180	4165	8330
D.	7 - 8	892	1785	XD.	181 - 210	4224	8449
E.	9 - 10	981	1963	XE.	211 - 240	4462	8925
F.	11 - 12	1130	2261	XF.	241 - 280	4789	9579
G.	13 - 14	1219	2439	XG.	281 - 320	5117	10234
H.	15 - 16	1338	2677	XH.	321 - 360	5444	10888
I.	17 - 18	1457	2915	XI.	361 - 400	5771	11543
J.	19 - 20	1547	3094	XJ.	401 - 475	6307	12614
K.	21 - 23	1695	3391	XK.	476 - 580	6723	13447
L.	24 - 26	1785	3570	XL.	581 - 690	7229	14458
M.	27 - 29	1874	3748	XM.	691 - 800	7764	15529
N.	30 - 32	1993	3986	XN.	801 - 920	8419	16838
O.	33 - 35	2082	4165	XO.	921 - 1050	9040	18080
P.	36 - 40	2201	4403	XP.	1051 - 1180	9698	19397
Q.	41 - 45	2321	4641	XQ.	1181 - 1290	10353	20706
R.	46 - 50	2469	4938	XR.	1291 - 1400	10977	21955
S.	51 - 60	2618	5236	XS.	1401 - 1580	11632	23264
T.	61 - 70	2856	5712	XT.	1581 - 1790	12286	24573
U.	71 - 80	3064	6128	XU.	1791 - 2000	12941	25882
V.	81 - 100	3272	6545				



DPS

Nr 4/1

Dosj

Dt. 05.02.2007



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT

Nr. 76/1.....Prot.


Tirane, me 1.2.....2007

Per: **DREJTORISE SE PERGJITHESHME TE STANDARDIZIMIT** ✓

TIRANE

Subjekti: **Miratim i tarifave te shitjes se standarteve**

Ne zbatim te vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 432, dt. 28.6.2006 "Per krijimin dhe administrimin e te ardhurave qe krijojne institucionet buxhetore", si dhe ne mbeshtetje te kerkeses se Drejtorise se Pergjithshme te Standardizimit, me shkresen nr.4, date 4.1.2007 miratojme tarifat e reja per shitjen e Standarteve Shqiptare dhe te huaja , sipas pasqyrave bashke lidhur.



Adresa:

Bul. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Tel: +355 4 222920, Fax: +355 4 222920
e-mail: budget.director@minfin.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT
Certifikuar sipas standardit ISO 9001:2000

Nr. 4 Prot.

Tiranë, më 04.01.2007

Rruga "Mine Peza" Nr.143/3
Tiranë
Kutia Postare Nr. 98

Tel: + 355 4 22 62 55
Fax: + 355 4 24 71 77
e-mail: info@dps.gov.al

Lënda: Miratimi i tarifave për shërbimet për të tretë.

**Ministritë së Financës
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit**

Tiranë

Në zbatim të VKM Nr.432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore" si dhe bazuar në Ligjin nr.8464, datë 11.03.1999 "Për Standardizimin, neni 9, pika 12, ju informojmë për arësyet e ndryshimit të disa prej tarifave të shërbimeve që kryen DPS-ja.

Lidhur me realizimin e nismës "Shqipëria 1 Euro" Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ka menduar të japë kontributin e saj duke propozuar një ulje të çmimit të shitjes së standardeve Shqiptare (S SH) krahasuar me çmimin e aplikuar deri tani, i cili ka qenë rreth 45% e çmimit të standardeve Europiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO/IEC). Ky propozim vjen gjithashtu edhe si rezultat i studimit të tregut, i cili ka rezultuar disi i lartë për t'u përballuar nga ana e blerësve tanë. Kjo ulje çmimi, krahas arësyeve të mësipërme, do të sjellë edhe rritjen e shitjeve të standardeve, që do të thotë zbatim në produktet dhe shërbimet vendase i një numri më të madh të standardeve EN aq të kërkuara për t'u arritur edhe në kuadrin e integritimit në BE.


Për këto arësye ju lutemi miratimin Tuaj për sa më poshtë vijon:

- Për të gjitha Standardet Shqiptare (S SH) qofshin këto puro shqiptare apo që adoptojnë Standardet Europiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO/IEC), çmimi i propozuar është rreth 30% e atyre EN, ISO dhe IEC, pra kemi një ulje prej 15% të çmimit të aplikuar deri tani;
- Për standardet Shqiptare (S SH) qofshin këto puro shqiptare apo që adoptojnë Standardet Europiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO/IEC) të kërkuara nga studentet propozojmë çmimin prej rreth 15% të çmimit të standardeve EN dhe ISO/IEC;
- Për personat (fizikë apo juridikë) të cilët blejnë më shumë se 10 standarde S SH (si më sipër të specifikuar) propozojmë t'i bëjmë një ulje prej 10% të totalit të vlerës së kërkuar;
- Për agjentët tanë të shitjes (institute, librari, laboratore etj) të cilët punojnë mbi bazën e një kontrate të lidhur midis DPS dhe atyre, (për të gjitha standardet si më sipër të specifikuar) mendojmë të aplikojmë çmimin 70% për DPS dhe 30% për ata;
- Për bashkëpunëtorët e DPS mendojmë të aplikojmë të njejtën vlerë që kemi aplikuar deri tani, pra 50% të vlerës së standardeve S SH (si më sipër të specifikuar).

Bashkëngjitur janë tabelat me çmimet e standardeve të vjetra dhe të reja sipas propozimeve të mësipërme.

Drejtori i Përgjithshëm


Arben NATI



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BUXHETIT

Nr. 15817/1 Prot.

Tiranë, më 23/11/2015

Drejtuar: MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES

Për dijeni: Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit

Subjekti: Shkresë për kompetence

Bashkëlidhur është një kopje e shkresës nr. 505, datë 11.11.2015 e Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit ku janë paraqitur për tu miratuar tarifat për shërbimet që Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit i ofron të tretëve.

Tarifat e propozuara dhe argumentet e paraqitura mendojmë të shqyrtohen nga ana juaj dhe më pas të bëhen propozimet përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

GELARDINA PRODANI

GProdani

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Kostanca!
Për mospunat procedurat.
25.11.2015
Hart